

UDHËZIM
Nr. 6/2, datë 3.4.2014

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 17, DATË 13.5.2008 “PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR”, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të ligjit nr. 7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 17, datë 13.5.2008 “Për TVSH-në”, bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

Në pikën 8.8.2.1, paragrafi i parë ndryshon me këtë përmbajtje:

“Për barnat e importuara dhe të prodhuara në vend, të pajisura me pullën e kontrollit me çmimin me TVSH 10%, me qëllim për t’u tregtuar (shitur) që rezultojnë gjendje në subjektet farmaceutike deri në datën 31 mars 2014, do të aplikohet TVSH-ja në masën zero përqind, në shitje, pavarësisht nga masa e TVSH-së që është e shënuar në pullë.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCIVE
Shkëlqim Cani